



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 6, datë 23.06.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:20

Data e mbajtjes së mbledhjes : 23.06.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Të nderuar këshilltarë! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë. Materialet Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit .

Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

31 Këshilltarë në sallë.

(V.O. Hyn me vonesë në sallë Edlira Shemsi dhe gjatë mbledhjes del nga salla Samet Vata dhe Sami Osmani. Gjithsej në mbledhje 32 këshilltarë)

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me mbledhjen.

Ardian Muka: Për procedurë.

Denisa Luarasi: Të lutem. Okay.

Ardian Muka: Siç e thatë dhe ju mbledhjen e thërret kryetarja e bashkisë por dhe në disa raste të tjera e kam ngritur këtë shqetësim dhe problem. Kryetari e bashkisë nuk vjen, e thërret mbledhjen, por nuk është prezent. Jo se kemi gjë, sepse natyrisht që është përfaqësimi me zëvendëskryetarin, por do thoja në qoftë se kryetarja e bashkisë është e pamundur, ka më shumë se tre muaj që nuk paraqitet të paktën në mbledhjen e këshillit. Do të donim një informacion në detyrat e tjera të saj, a është prezente apo kryetarja e bashkisë nuk është prezente? Dhe pastaj duhet të fillojnë procedura të tjera. Kaq kisha. Faleminderit. Një përgjigje doja. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Ja po sqaron.

Gentian Kallmi: Kryetarja e bashkisë është në krye të detyrës para se të zgjoheni dhe ju edhe mbasi fleni ju.

Denisa Luarasi: Vazhdojmë me mbledhjen. Faleminderit zoti nënkryetar.

Me kërkesë të kryetares së bashkisë, sot kemi një shtesë në rendin e ditës dhe propozoj që ta lexoj së bashku me tre pikat dhe pastaj ju ftoj që ta votojmë bashkë me shtesën dhe më pas do ftoj drejtoreshën juridike sipas Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak të na sqarojë arsyen e shtimit sot të pikës së katërt të rendit ditës. Atëherë po fillojmë me leximin dhe ju ftoj më pas që ta votojmë me shtesë.

- **Pika 1.** “PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN QERSHOR 2025”
- **Pika 2.** “PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2024”
- **Pika 3.** “PËR MIRATIMIN E FUNKSIONIMIT TË QENDRËS “FUQIZOJMË KOMUNITETIN” ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITET 2025-2027 DHE BUXHETI I BASHKISË Durrës”
- Po ju lexoj dhe **pikën shtesë, pikën e 4-t.** “PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 110, DATË 16.12.2024, “PËR

MIRATIMIN E VLERËS SË SHPRONËSIMIT PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN APO ZHVLERËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT TË RIJETËZIMIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “TID” DURRËS, PËR ZHVILLIMIN DHE RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE””,

Përpara se t'ju ftoj në votim, dua të ftoj drejtoreshën juridike të na sqarojë për këtë pikë.
Po, zonja Rroshi, faleminderit.

Alneida Rroshi: Të nderuar këshilltarë, pas miratimit të Vendimit nr 110, datë 16.12.2024 në Këshillin Bashkiak është paraqitur plotësimi nga Agjencia Shtetërore për Shpronësim me shkresën nr 107, “Plotësim dokumentacioni” ku ka kërkuar që, vlerësimi i pasurive për objektet, të cilat janë njësi të vlerësohen sipas VKM-së nr 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpërsohen dhe vlerësohen të të drejtave të personave të tretë për interes publik”. Vlerësimi i të gjithë objekteve të tjera të ndërtimit të vlerësohet sipas metodës së kostos të ndërtimit nga ministritë përkatëse dhe konkretisht çmimet të merren si mesatare e tregut. Vlerësimit t'i zbritet amortizimi. Sa më sipër, vlerësimet të bëhet me preventivë punimesh ku të përfshihen foto, planimetri, të dhëna teknike, të cilat citohen. Gjithashtu më duhet të citoj, për të përmbledhur kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe për të siguruar legjishmërinë e shpronësimit propozohet miratimi i projektvendimit për ndryshimin e vlerës së shpronësimit për ato objekte të cilat kanë nevojë që të bëhet vlerësimi me VKM-në numrin 138, të vitit 2000. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Rroshi.

Ta hedhim në votim rendin e ditës edhe pastaj komentojmë.

Ta miratojmë me shtesë rendin e ditës.

Kush është pro?

Dorina Milja: 27

Denisa Luarasi: Kundër?

Dorina Milja: 4

Denisa Luarasi: Abstenim?

Atëherë miratohet me 27 vota pro rendi i ditës me shtesën përkatëse.

Dhe ftoj.....

Po z. Muka.

Ardian Muka: Ka qenë realisht, ka qenë pjesë e opozitës, e cila ka kërkuar që të bëhet rivlerësimi dhe për këtë pjesë na vjen mirë që e keni sjellë si material, por neve nuk jemi dakort për mënyrën se si po veprohet nga ana e bashkisë edhe me këshillin. Mbledhjet nuk mund të vijnë në orën 12 e 10 minuta materiali dhe të kalojë në këshill, koha dihet duhet të jenë pesë ditë para, na e sillni materialin sot, pas 5 ditësh mbledhemi prap neve.

Denisa Luarasi : Meqë është një pikë e veçantë e lejon rregullorja.

Ardian Muka: E kuptova. Prandaj thashë, neve jemi për ta kaluar sepse kemi qenë ne që e kemi, e kemi sjellë, por mënyra se si sillet jashtë të gjithë afateve, në orën 12:10 na ka ardhur materiali me email, për këtë neve nuk jemi dakort që të jetë në këtë mbledhje. Jemi dakord të shqyrtohet në çfarëdolloj momenti tjetër brenda afateve ligjore. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Si procedurë ftoj komisionet, Komisionin e Rregullorës, Çështjeve Juridike, Komisionin e Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, Komisionin e Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor të mblidhen.

Do mblidhet komisioni të vendosë. Do bëjmë një pushim derisa të vendosi, të vendosin komisionet për këtë pikë tek zyra e sekretares së këshillit. Ne të tjerët do presim sa të merret vendimi dhe të vazhdojmë me miratimin dhe shqyrtimin e pikave. Dakord?

(.....Mblidhen 3 komisionet te Zyra e Sekretarisë)

Denisa Luarasi: Rifillojmë.

Falenderoj komisionet për vendimet e tyre.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1**, Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonjës Eda Harizi.

Edlira Shensi: Po atëherë Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit pasi mori në shqyrtim familjet dhe personat që kanë kërkuar asistencë dhe ndihmë ekonomike nga bashkia e Durrësit brenda fondit limit 6% dhe fondit të bashkisë, të ardhura të bashkisë për të gjithë rrethin e Durrësit, ramë dakort që kjo listë të miratohet dhe ja delegojmë për miratim Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Harizi.

Komente, pyetje ka?

Kalojmë votim.

Kush është pro për pikën 1?

Kundërshtim s'ka.

Miratohet me 30 vota pro. Miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Përshëndetje të gjithëve.

Atëhere komisioni ynë pikën 2 e miratoi me shumicë votash dhe propozon sot Këshillit që ta miratojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave zotit Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe Komisioni i Buxhetit me shumicë votash e kalon pikën për miratim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komente, pyetje kemi?

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Fakti që vijmë për miratimin e përdorimit të fondeve të trashëguara nga viti 2024 tregon edhe njëherë atë çfarë neve kemi thënë në miratimin e buxhetit kur bëmë 2024-ën që, ky buxhet ishte një buxhet jo real, ishte një buxhet jo me këmbë në tokë për ato çfarë janë interesat e qytetarëve durrsak dhe për atë çfarë bashkia duhet të realizonte në funksion të mbledhjes së taksave dhe përkthimin pastaj atë në shërbimin ndaj qytetarëve. Fakti që në pikën A1 fonde të papërdorura për vitin 2024 në kapitullin të ardhurat e veta janë 492 milion, flasim me të reja gjithmonë, 459234 lekë dhe fonde të papërdorura për vitin 2024 në kapitull transferta të pakëzuara transferta sektoriale 339 milion 773.949 lekë fonde, pika A2.1 fonde të papërdorura për transferet e pakushëzuara janë për vitin 2024, më falni një sekondë, 192 617 512 lekë dhe fonde të papërdorura nga transferta e pakushtëzuar sektoriale. Të gjitha bashkë duke futur dhe fondet nga taksat dhe tarifat e arkëtuara nga bashkia gjatë vitit 2024 deri me 31 dhjetor 2024 janë 661 milion 949.250 për një total të fondeve të trashëguara nga viti 2024, 1 miliard 494 milion 179.434 lekë, pra flasim rreth 14 milion e gjys euro duke pasur parasysh që gjithë buxheti i bashkisë shkon rreth 40 e diçka milion, po flasim që rreth 30% e fondit pra të gjithë të ardhurave që ne kemi nga të gjitha këto pjesë të hyrjeve që lexova pak më parë bashkia e Durrësit nuk i ka vënë në dispozicion të shërbimeve për qytetarët. Dhe po të shohim pastaj tabelat me zbërthimin e të gjithëve, natyrisht nuk mund të mungonte zëri i transferimit, menaxhimit të mbetjeve, i cili është i vetmi zë i realizuar 100% dhe është zëri që ne e kemi kontestuar gjatë gjithë kohës duke pasur parasysh që mbetet që shkojnë në Landfillin e Sharrës janë mbetje të cilat nuk trajtohen, nuk digjen por janë mbetje të cilat trajtohen thjesht si mbetje normale, mbetje urbane dhe ndërkohë që me një analizë që kemi bërë kostos, qytetarët, Durrësi paguajnë rreth 42 euro për ton, shifër që për mendimin tim është jashtë çdo norme, duke pasur parasysh që për të njëjtën gjë Tirana trajtimin e mbetjeve urbane dhe ato paguan 29 euro për tonë, por nuk kanë këto shtesat e tjera që kemi ne duke futur TVSH-në, transportin e tjerë.

Pra duke pasur parasysh që në mosplotësimin e zërave nga ana e bashkisë, megjithëse ka pasur këto fonde në dispozicion si nga të ardhurat e veta ashtu dhe nga të ardhurat e pakushëzuara, pra të ardhurat që vijnë nga qeveria, nuk kuptoj që pse neve duhet të riallokojmë prapë fonde që në fund të vitit 2025 të mbledhemi prapë dhe transferojmë prapë 14 apo 15 milion euro për vitin 2026. Do propozoja që natyrisht bashkia të ulëj me këmbë tokë, të bënte një plan realist dhe mos të vinte me çdo vit me këtë pjesën e riallokimit. Natyrisht kjo është pjesë e procedurës, është normale që këto të bëhen, por duke pasur parasysh që fondet nuk kanë shkuar aty ku duhet dhe mungesat kryesore janë në pjesën e infrastrukturës, në pjesën e shkollimit dhe në pjesën e sporteve, gjë të

cilat realisht neve të gjithë si qytetarë e dimë që qyteti jonë ka mangësi. Tamam aty neve nuk kemi shkuar për të realizuar atë çfarë kemi pasur mundësi. Pra fondet i kemi pasur për paaftësi të bashkisë, për inkompetencë, unë them që këto nuk janë realizuar për këto fakte. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Kalojmë në votim.

Gentian Kallmi: Thjesht për sqarim zoti Muka.

Konstatimi juaj është i gabuar, sepse bëhet fjalë për fonde të trashëguara nga viti 2024 për kontratat të cilat janë të lidhura, investime të realizuara gjatë vitit 2024 dhe janë në proces zbatimi dhe pjesa më e madhe e fondeve të trashëguara do të përdoren për mbylljen e këtyre kontratave, financimin e tyre për realizimin e investimeve që ju sapo përmendët që nuk janë realizuar.

Kjo ishte thjesht për sqarim. Në qoftë se keni pyetje konkrete, po faleminderit.

Ardian Muka: Atëherë në faqen 3, në fund pjesën e fundit, pra gjendja e fondit të trashëgueshme në fund të vitit 2024 rezulton të jetë 1 miliard 494 dhe bishta. Nga këto fonde në planin e të ardhura të buxhetit të vitit 2024 u parashikuan vetëm 450 milionë “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bushkisë për vitin 2025”, sepse nuk kishim një informacion të saktë mbi fondin që do të mbeteshin pa përdorur kurse diferenca prej 1 miliard e 44 milion thashë mbeti e pa planifikuar.

Rolant Xhelilaj: Jo ndërprite se është sikur po bën analizë të këtij projektvendimi, tashi këtu në mbledhje e ka marrë përpara, po e lexon dhe po bën analizë nuk është korrekte për këshillin duhet të ishte në komision ose Muka ose kushdo përfaqësues dhe në të gjithë komentin që bën ka ato lëkundjet e veta. Ne e pranojmë një koment të tillë, sepse ka vetëm karakter politik. Ai i sheh gjithmonë me syze të errëta edhe konkluzionin që kjo vjen për paaftësi të bashkisë, se nuk i kryen mirë punët, se qytetarët durrsak e dinë që këtu punët nuk shkojnë mirë te arsimi, te sporti janë të gjitha të thënat teorike, që në pozicionin që ka normal, ripërsëritja. Nënkryetari dha përgjigjen në komision ishte gjithë mundësia të trajtohet problemi dhe këtu vihet dhe trajtohet specifikisht një gjë që, kjo ja ku ka ngelur, pse ka ngelur që dhe bashkia të japi opinionin e saj. Fakti i alokimit është procesi më normal që ndodh me buxhetet. Gjithmonë ka fonde të trashëguar nga viti paraardhës te viti tjetër dhe në të njëjtën kohë janë kontrata, të cilat janë në vazhdim e sipër. Teorikisht e mbylli ciklin e diskutimit, kështu që ridiskutim për një pikë që komisioni e ka analizuar, e ka pranuar është proces më se normal, më duket jo korrekt.

Ardian Muka: Besoj që fjalën duhet të ma japi dhe duhet të ma heqi kryetarja e këshillit. Jo, kryetari i grupit të Partisë Socialiste.

Denisa Luarasi : Nuk ta kam heq mikrofon.

Ardian Muka: Jo, ai ma mori. Ai e mori fjalën, ndërkohë që unë flisja, mikrofonin me gjithë respektin për zotin Xhelili, e mori fjalën ndërkohë që unë flisja dhe po bëja një replikë me atë

çfarë tha zëvendëskryetari ku edhe po i shpjegoj 450 milionë, unë nuk kam qenë në komision se nuk jam anëtar i këtij komisioni, jam anëtar i komisioneve të tjera. 450 milionshin është ok zëvendëskryetari, pra që janë kjo pjesa kontraktore me aq sa unë kuptoj pjesa e dhjetshes është pjesë që rialokohet është normale që mund të bëhen. Nuk i heq asnjë presje asaj çfarë thashë. Këto fonde nga ana e bashkisë nuk janë të mirëorganizuara, nuk janë të mirëmenduara. Duhet që bashkia të ulet me këmbë në tokë përsa i takon pjesës së buxhetit. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 2 të rendit i ditës?

Denisa Luarasi: Kundra?....

Dorina Milja : 3

Denisa Luarasi: Abstenim.... s'ka.

Me 27 vota pro. Miratohet pa ndryshime pika 2 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 3**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë edhe për pikën 3 komisioni ynë e miratoi me shumicë votash dhe ftojme Këshillin sot që të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave, Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe Komisioni i Buxhetit e kalon më shumicë votash pikën për miratim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komisioni të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zonja Edlira Shemsi.

Edlira Shemsi: Flasim për miratimin e fondeve, më fal. Flasim për pikën e fondeve për miratimin e funksionit të qendrës “Fuqizojmë Komunitetin”, fonde që kalohen te bashkia e Durrësit në mbështetje nga programi i fondit social të buxhetit të shtetit për vitin 2025-2027 dhe buxheti i bashkisë Durrës. Në këtë pikë unë doja të jepja ato objeksionet e mia që i dhashë edhe në komision, sepse bëhet fjalë që të kalojë edhe Qendra Ditore e të Moshuarve të kalojë të merret nga kjo shoqatë joqeveritare te shoqata Fuqizojmë Komunitetin t'i kalohen dhe fondet që janë fonde të bashkisë së Durrësit. Në komision ne bëmë kërkesë, erdhi dhe drejtoresha asistencës sociale, në Durrës në bashki, zonja Meme Xhaferaj edhe anëtarë të tjerë dhe bëmë pyetje dhe bëmë dhe debate lidhur me çështjen në fjalë.

Bëhet fjalë të kalojë në këtë shoqatë joqeveritare edhe fondi i Qendrës Ditore të Moshuarve, një fond rreth 120 milionë lek të vjetra që është dhënë në këto vite nga bashkia e Durrësit. Me arsyetimin kur u pyetëm ishte që duke qenë që kjo qendër paska një NIPT dhe nga ana financiare është më kollaj të alokohen fondet nëpërmjet kësaj qendre. Po deri me sot si i ka alokuar bashkia e Durrës? Kush e ka audituar këtë qendër? Sigurisht që janë lekë që janë dhënë dhe janë audituar që si janë shpenzuar. Pse duhet të kalojnë tani te kjo qendër dhe ajo që është që të bën domethënë realisht të aludosh dhe të ngresh pyetjen që çfarë po bëhet me fondet e bashkisë Durrës, por dhe fonde të dhëna dhe nga qeveria që kalojnë nga bashkia dhe i alokohen dhe të përdoren nga qendra Fuqizojmë Komunitetin nga kjo qendra e një shoqate joqeveritare, sepse jepet argumenti që duke qenë që për shkak të ndryshimeve që ndodhen në Amerikë fonde të PNUD-it dhe USAID janë bllokuar për disa programe të caktuara në Europë edhe në gjithë botën dhe në këto në këtë kuadër thotë ne duam ta vazhdojmë deri në 2026-ën. Fondet janë ndërprerë, prandaj duhet të vazhdojmë të bashkëpunojmë dhe të marrim alokim fondesh nga bashkia e Durrës.

E para një herë na është dhënë një, unë kërkoja një raport, mu soll një raport në komision në lidhje me gjithë si të thuash shërbimet që kjo qendër kishte ofruar nga fonde që janë fonde që PNUD-i në fakt ja akordoi bashkisë Durrës, por që bashkia e Durrës nuk i mori asnjëherë vetë në dorëzim këto fonde dhe PNUD-i bëri një nënkontratë me USAID-in dhe Bashkia e Durrës nuk bëri kontratë mbi qendrën Fuqizojmë Komunitetin, por që USAID që bëri kontratë mbi qendrën Fuqizojmë Komunitetin për fonde që u dhanë për këtë kategori sociale, për ndihmën e tyre në bashkinë Durrës, por që u deleguan, u transferuan te qendra komunitare te kjo shoqata joqeveritare “Fuqizojmë komunitetin”. Domethënë fondet erdhën për bashkinë, bashkia nuk i pati asnjëherë vetë në dorë ato fonde. Nuk e di pse. Nuk qenë në gjendje bashkia që ka personel në shërbim, ka drejtorin dhe ka në çdo njësi administrative personel që merret me probleme sociale. Nuk diti bashkia në Durrës që fondet e dhëna nga PNUD-i t'i menaxhonte vetë, t'i çonte vetë te komuniteti, te shtresat në nevojë? Që duhet t'ia jepte pastaj bashkia t'ia çonte kësaj shoqatës. Përgjigja që mu dha është jo, bashkia nuk ka një kontratë me këto shoqatë, por është PNUD-i, i cili bëri një nën kontratë me USAID-in dhe USAID bëri pastaj kontratë me qendrën Fuqizojmë Komunitetin. Domethënë është një lojë telefoni prish, një lojë trishe që fondet nuk i mori bashkia që shumë mirë mund t'i menaxhonte vetë, por i mori kjo shoqata.

Më kanë sjellë dhe një raport lidhur me të gjitha shërbimet që ka ofruar shoqata, por pa emra konkret disa numra të cilat nuk ky nuk është një raport, ky nuk është një raport i qartë, një raport analitik me disa numra që kemi dhënë për fëmijët me prapambetje mendore. Kaq, për psikiatren, për psikologun, për logopedistin, për familjet në nevojë kaq numra, por pa emra konkret. Dhe kur pyeta kush i ka audituar këto fonde, përgjigja që më dha nga përfaqësuesja e bashkisë ishte, ne nuk kemi të drejtë auditimi të fondeve të një shoqate që nuk është pjesë e bashkisë. Atëherë këto fonde që në fakt ishin dhënë për bashkinë, por shkuan për këto shoqatë, kush i ka audituar? Ne kërkuam si komision dhe në këtë pikë u dakordësuam që të gjithë që ne kemi të drejtë që të kërkojmë jo vetëm të na jepet një raport i hollësishëm, i detajuar analitik, por të kërkojmë të bëhet një auditim. Një auditim bëhet se këto kanë një NIPT dhe këto dhe këto kooperojnë dhe shërbejnë brenda Republikës së Shqipërisë. Kush i ka audituar këto fonde? Këto fonde që kanë dhënë për bashkinë Durrës dhe si këto si këto më fal të lutem.....

Denisa Luarasi: Kemi drejtoreshën këtu dhe të na sqaroj dhe ne të tjerët.

Edlira Shemsi: Jo patjetër çfarë t'ju sqaroj. Më pyesni dhe ju përgjigjem.

Denisa Luarasi: Drejtoresha të sqaron. Është drejtoreshë.

Edlira Shemsi: Jo, drejtoreshën kam pyetur këto përgjigje, i kam pyetur me drejtoreshën dhe sigurisht që ka të gjithë të drejtën të sqarojë dhe pjesën tjetër të këshilltarëve pa diskutim. Por që si i paskemi menaxhuar ne fondet të Qendrës së Moshuarve, këto 120 milionë lekë të vjetra për ushqime, për personel. Ne sigurisht që kur i kemi dhënë si bashki mendoj që dhe janë audituar. Po s'kemi pasur nevojë për NIPTIN e një shoqate OJF që të kalonim lekët, se lekët s'kanë qenë të shoqatës, lekët kanë qenë të bashkisë dhe të qeverisë shqiptare.

Denisa Luarasi: Kaloj minutazhi të lutem. Faleminderit.

Flutura Kasa: Të lutem shumë respekto minutazhin. Faleminderit.

Edlira Shemsi: Unë do flas aq sa është e nevojshme.

Flutura Kasa: Ke të drejtë në çdo gjë që the doktoresha, por ke një minutazh përmbledh diskutimin. Kemi që në 11 këtu.

Edlira Shemsi: Zonja Futura s'kam ndërhyrë asnjëherë kur ke folur ti edhe pa leje edhe pa qenë kryetare e komisionit. Unë kam gjithë të drejtën të flas si kryetare e komisionit për fonde që bëhet fjalë për qindra milionë.

Moj zonjë e nderuar. Bëhet fjalë për qindra milionë që këto po të ishin menaxhuar. Unë nuk dua të aludoj. Nuk dua të aludoj dhe të paragjykoj që janë keqmenaxhuar, por është e drejta jonë të kërkojmë, e drejta jonë e të gjithë këshilltarëve këtu, jo e drejta ime, të kërkojmë pse janë dhënë kështu me rregull treshi nga PNUD-i te USAID-i, nga USAID-i te shoqata dhe jo nuk janë dhënë drejtpërdrejt bashkisë, sepse bashkia duket, bashkia është përfituesja thuhet dhe pse nuk janë bërë me bashkinë.

E para, e dyta, fondet e Qendrës Ditore të Moshuarve si janë menaxhuar deri tani? S'paskemi pasur NIPT ne që tani për shkak të NIPT-it do i kalojë shoqatës.

Denisa Luarasi: Të lutem. Faleminderit.

Edlira Shemsi: Apo janë ndërprerë tani fondet e PNUD-it? Janë ndërprerë fondet e PNUD-it dhe të USAID nga Amerika nga departamenti i shtetit janë ndërprerë fondet e PNUD-it.

Denisa Luarasi: Pak më me qetësi zëri.

Si vendosi komisioni? Ju lutem.

Zonja Harizi si vendosi komisioni?

Rolant Xhelilaj: Kryetare e seancës.

Denisa Luarasi: Si vendosi komisioni?

Edlira Shemsi: Kërkuam ta na jepet informacion i detajuar.

Rolant Xhelilaj: Zonja Harizaj.

Edlira Shemsi: Urdhëro zoti Xhelil. Komisioni ka të drejtë të japi dhe atë opinion që thatë ju dhe ju keni të drejtë të plotë që ta analizoni çështjen në të gjithë gjerësinë dhe gjatësinë e saj, por vetëm për atë çështje që shtrohet. Kurse ju bëtë një amalgamë, probleme shoqatash, gjërash të cilat ne themi është mirë....

Edlira Shemsi: Jo shoqatë numri njëjës dhe jo amalgan problemesh. Vetëm dy probleme të cilat janë të shkruara këtu.

Rolant Xhelilaj: Mirë pra, mirë. Ti e dhe opinionin tënd, të jap dhe unë timin. Dhe në këtë opinion që the, mund t'i drejtohesh bashkisë për një informacion suplementar për ato gjëra të cilat ti i konsideron të paqarta për vete, por ndonjë rast tjetër dhe për komisionin. Në pikën që shtrohet aty është një shoqatë "Fuqizojmë Komunitetin". Mendohet t'i jepen fonde edhe nga qeveria dhe nga bashkia dhe opinionin jonë është shumë mirë që këtyre organizatave, këtyre shoqatave ju jepen fonde të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës së komunitetit në ato zona.

E ka e kalova edhe unë. Bëj autokritik, po që se e kaloj. Dhe në këto kushte dhe kryetarja që drejton seancën duhet të jetë pak më e kuadratuara te komentet, komenti i pikës. Pastaj ke probleme të tjera, drejtoju bashkisë të vijë, të informojë, të raportojë, ku e di unë, të tjera me radhë. Për pikën në fjalë, qëndrimi jonë si grup është shumë mirë që ka politika të tilla, të cilat ndikojnë pozitivisht për komunitetin dhe ne si grup e votojmë këtë pikë.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Po znj. Xhaferaj

Meme Xhaferaj : Lidhur me qendrën, ne bashkia miraton fondet që kemi aplikuar në muajin tetor për qendrën Fuqizojmë Komunitetin. Pasi qendra Fuqizojnë Komunitetin, Bashkia e Durrës e ngriti në partneritet me PNUD-in. PNUD kishte fonde të marra nga USAIDI për të ngritur në tre bashkitë të vendit, Kurbin, Lezhë dhe Durrës, qendra që fuqizojnë komunitetet në nevojë. Duke qenë sepse kjo qendër ishte qendër ekselente, qendër model me një skuadër profesionistësh të kompletuar. E pamë që mbulonte shumë nevoja në fakt në bashkinë Durrës dhe në 26-ën bazuar te marrëveshja që kishim me PNUD-in do ndërpriteshin fondet deri ishte parashikuar. Duke qenë se qendra kishte një staf prej 20 punonjësish, 15 me kohë të plotë dhe 5 me part time, ne aplikua që gradualisht bashkia të planifikonte me fondet e veta një pjesë të stafit, pasi një pjesë do ishte në 2026-ën. Një pjesë tjetër duhet ta planifikonim ne gradualisht dhe çfarë bëmë në muajin tetor

kur Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale hap thirrjen për projekte sociale, ne aplikuar në ministri për të mbajtur një pjesë të stafit me fondet e projektit dhe duke qenë se aplikuar, na e dhanë këtë fond në janar, bashkia firmosi një marrëveshje me Shërbimin Social Shtetëror për të kaluar një strukturë prej shtatë punonjësish me fonde nga ministria. Situata rrodhi e tillë që në janar u ndërprene fondet nga USAID-i dhe pjesa tjetër e skuadrës ngeli jo vetëm e papunë, por ndërkohë dhe ne nuk po ofronim shërbime qytetarëve. Prandaj sot jemi këtu për të miratuar fondin që ka ardhur nga ministria dhe fondin për 8 punonjësit e tjerë që janë logopedë, janë psikologë, janë shërbimi lëvizës me punonjës social dhe struktura të tjera që ofrojnë terapi për individët se kemi dhe fizioterapisë. Pra është një skuadër sipas relacionit që ofron shërbime në komunitet, në qendër dhe në njësi rurale nëpërmjet shërbimit lëvizës.

Bashkia nuk i jep fonde organizatës. Këtu të jemi të qartë. Bashkia planifikon fondin që vjen nga ministria, e miraton dhe fondin e saj për 8 punonjësit e tjerë. Kjo është .

Denisa Luarasi: Faleminderit drejtoresha.

Edlira Shemsi: Bashkia nuk jep fonde organizatës, por paguan punonjësit e organizatës.

Meme Xhaferaj: Si paguan punonjësit e organizatës? Bashkia, më fal.

Denisa Luarasi: Doktoresha të lutem mikrofonin.

Edlira Shemsi: Pra punonjesit logop e tjerë e tjerë, me radhë punonjë social bashkia po miraton për të paguar punonjësit e shoqatës apo këta punonjës do të jenë strukturë e bashkisë.

Meme Xhaferaj: Punonjësit do të jenë me kontrata të lidhur nga titullari i bashkisë Durrës.

Edlira Shemsi: Pranë shoqatës, jo pranë bashkisë.

Meme Xhaferaj: Absolutisht jo. Punonjësit punojnë pranë qendrës, fuqizojmë.

Edlira Shemsi: Po pra qendrës, pranë shoqatës. Pikërisht po them, ne po paguajmë, ne po paguajmë punonjësit e shoqatës që kanë bërë një kontratë me bashkinë apo jo? Sepse për shkak të ndërprerjes së fondeve të PNUD dhe të USAID për ndryshimet që ndodhën në Amerikë.

Meme Xhaferaj: Më fal, për mua më fal je e keqinformuar, sepse qendra nuk është e organizatës. Ne kemi një marrëveshje me PNUD-in edhe nëse do ta shihni po ta dërgoj ...

Edlira Shemsi: Fonde të cilat janë ndërprerë nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Meme Xhaferaj: Objekti i marrëveshjes është që PNUD-i të ndihmojë bashkinë Durrës që të ngrejë shërbime të tilla në komunitet.

Edlira Shemsi: E t'ja ja delegoi shoqatës, organizatës si do t'ja vëmë emrin.

Meme Xhaferaj: Dhe PNUD-i ka kontraktuar një shoqatë që deri në dhjetor mbështeti bashkinë me ekspertizën.

Edlira Shemsi: Po ligjërisht e kishit ligjërisht të drejtë që PNUD të jepte fonde bashkisë Durrës ndërkohë të gjente një shoqatë nënkontraktuese për t'ia dhënë një OJF-je?

Meme Xhaferaj: Bashkia Durrës unë them nga eksperiencia

Eldira Shemsi: Jo unë them nga ligji, jo nga eksperiencia.

Meme Xhaferaj:nga partneritetet që ne kemi pasur.

Denisa Luarasi: Ta hedhim në votim.

Meme Xhaferaj: Çdo shërbim që kemi ngritur me partnerët. Më fal pak, e them me përgjegjësi që bashkia e Durrës ka qenë e suksesshme në implementimin e këtyre projekteve, sepse këto shërbime i ka trajtuar me të njëjtin standart.

Edlira Shemsi: Jo dhe kur të pyeta për t'i audituar me thatë nuk kemi të drejtë auditimi tek shoqata.

Flutura Kasa: Faleminderit shumë drejtoresha na sqarove.
Kaloje në votim aman.

Edlira Shemsi: Shumë të sqaruar.

Denisa Luarasi: Po Muka.

Po tani kur ka mbivendosje nga doktoresha normal që s'kuptohet gjë, se drejtoresha....
Hape mikrofonin Muka. Hape mikrofonin të lutem.

Ardian Muka: Doktoresha na lër një minutë vetëm.

Okay, atëherë për drejtoreshën kisha nja dy pyetje.

Atëherë do të doja të kuptoja si është organizuar ky partneriteti ndërmjet bashkisë dhe funksionimit të qendrës Fuqizojmë Komunitetin. Ku është bazuar pra ligji ku është bazuar për të krijuar këtë partneritet? Sepse më duket pak ambigue. Pra, fondet e PNUD kanë financuar, fuqizojnë komunitetin, ndërkohë që ka ndërhyrë edhe bashkia me 8 punonjës, po në funksion të fuqizojmë komunitetin. Ky 120 milion që ne aprovojmë është thjesht për rrogat e këtyre tetë punonjësve që bashkia ka bashkangjitur te ky te fuqizojmë komunitetin apo është financim i gjithë projekteve që fuqizojnë komunitetin?

Kam edhe disa pyetje të tjera. Në qoftë se doni i bëjmë pyetje, përgjigje, pyetje, përgjigje ose t'i them të gjitha dhe na u përgjigj për të gjitha.

Pyetja tjetër është, a ka një garë për shpalljen e fuqizojmë komunitetin si kompani fituese të këtyre fondeve? Atëherë qendra, kjo qendra ka disa punonjës. Këto punonjës janë punonjës e bashkisë? Jo jo, sot sot janë punonjës bashkie këto apo janë një shoqatë që quhet kjo Fuqizojmë Komunitetin që jep këtë shërbim. Atëhere objekti nuk jep aktivitet. Kush është? Pra 120 milion që ne japim kësaj godinës ja japim në funksion të një shërbimi që jepet aty brenda.

Zoti zëvendëskryetar, fondet që ne i japim, i japim në funksion të shërbimit që kjo po quajmë kjo qendër jep. Atëherë kjo qendër është partneritet i bashkisë me një organizatë OJF. Pra qendra kush jep shërbimin është një partneritet ndërmjet bashkisë dhe OJF-së? Këtë e dua ta di dhe si është realizuar kjo lloj, ky lloj fuzioni që është kryer.

Pastaj kam dhe një dy pyetje tashi t'i mbaroj unë dhe pastaj mu përgjigj për të gjitha. A ka një garë për të shpallë këtë OJF, pra që kemi marrë meqënëse paska këto ortopedët, paska një strukturë shumë të ngritur, shumë mirë të organizuar dhe e kemi shpallë këtë fituese apo bashkia ka zhvilluar dhe një tender dhe pastaj ka shpallë fitues këtë organizatë, e cila është bashkangjitur bashkisë? Pyetje tjetër. Po në këtë moment pyetje tjetër. Janë të rëndësishme besoj këto që po kërkoj.

Denisa Luarasi: Pak qetësi të lutem.

Ardian Muka: Kush i auditon fondet që do japi bashkia? Meqënëse nuk është më PNUD-i, do jetë bashkia që do bëjë auditimin?

Dhe një pyetje tjetër, sa fonde kanë marrë shoqat e tjera që japin pak a shumë këto lloj shërbimesh në qytetin e Durrësit nga ana e bashkisë së Durrësit? Faleminderit.

Meme Xhaferaj: Në radhë të parë është një qendër sociale siç janë 5 qendrat e tjera që bashkia ka, qendra e Nishtullës, Qendra Ditore e të Moshuarve, janë shërbime siç ka bashkia ndërmarrjet në varësi të bashkisë edhe këto shërbime sociale janë në varësi të bashkisë, janë staf bashkie, nuk janë, nuk janë organizata.

Nuk e di sa e qartë jam, po është siç janë ndërmarrjet në varësi të bashkisë edhe kjo është një shërbim i ri, është një qendër e re që ofron shërbime sociale për grupet në nevojë. Deri në ditën sot këtu ne po miratojmë këtë fond. Ka qenë me fonde të organizatave. Ne i kemi marrë fonde organizatave, nuk i kemi dhënë. PNUD-i ja dha organizatës punët e veta se si ndoqi procedurat që nuk i kemi hyrë ne me bashkinë. Pati marrëveshjen që deri në momentin sa u ngrit shërbimi ne t'i ofronim ambientin. Tani që u ndërpre fondet bashkia ka detyrimin këtë shërbim të ngritur ta vazhdojë. Për këtë qëllim jemi këtu sot.

Denisa Luarasi: Faleminderit drejtoresha.

Kalojmë në votim.

Meme Xhaferaj: Janë të gjithë punonjës që do nënshkruajnë kontrata me kryetaren e bashkisë. Më fal pak, nuk kemi bërë procedura tenderimi, sepse nuk japim lekë organizatave në këtë moment. Është qendër.

Denisa Luarasi: Kalojmë votim.
Kush është pro pikës së 3 të rendit të ditës?
Jemi dakord?

Dorina Milja : 29 pro

Denisa Luarasi: Kundër ?

Dorina Milja : 1

Denisa Luarasi: Abstenim ?....
Me 29 vota pro dhe 1 kundër miratohet pa ndryshime.
Kalojmë. Ju lutem pak qetësi.

- Kalojmë tek projektvendimi i **pikës 4** që është shtesë. I jepet fjala Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Jonada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën 4 ne me shumicë votash si komision e miratuar sot dhe kërkojmë që dhe Këshilli ta votojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
I jepet fjala Komisionit Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonjës Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Edhe ne në komisionin tonë ramë dakort ta kalojmë për Këshill për miratim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Mamo.
I jepet fjala Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor zotit Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.
Edhe Komisioni i Pronave e kalon me shumicë votash për votim në Këshill Bashkiak

Denisa Luarasi: . Shumë faleminderit.
Kemi komente, pyetje?
Po zoti Muka, vetëm pak shkurt se e ke tejkaluar kohën.

Ardian Muka: Dy minuta.

Denisa Luarasi: Jo, pesë minuta ke folur.

Ardian Muka: Tani për këtë pikë të projekt të vendimit neve thamë që nuk jemi dakort për mënyrën si u fut, por nga ana tjetër duke pasur parasysh që ne kemi kërkuar që të gjithë personat, të cilët preken nga projekti i tij të marrin atë çfarë i takon, pra të marrin çmimet për shpronësimin e pjesëve që atyre i marrin. Tokë, njësi, apartamente apo njësi tregtare të marrin atë çfarë është vlera e tregut. Këtë e kemi thënë nga dita e parë, e kemi votuar kundra kur ka qenë projekti, por jemi për këtë pjesë. Fakti që tashi sillet që pjesa njësi nuk do kalojë as me atë çfarë neve kemi vendosur në Vendimin e Këshillit paraprakisht, por kërkohet ndryshimi që të shpronësohen me vlerën e Entit Kombëtar të Banesave, ne nuk jemi dakort për këtë pjesë. Jemi që ky vendim të rri ashtu siç ka qenë. Pra që të gjithë banorët të marrin minimalisht, minimalisht aq sa neve kemi kaluar në Vendimet e Këshillit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 4 shtesë?

Dorina Milja : 27 pro

Denisa Luarasi: Kundra?

Dorina Milja : 3 kundër

Denisa Luarasi: Abstenim?

Me 27 vota pro miratohet pa ndryshim edhe pika 4 shtesë e rendit të ditës.

Nuk kemi kërkesë për diskutim.

Ju falenderoj shumë për prezencën dhe angazhimin tuaj.

Për mbledhjen e radhës ju njoftojmë nëpërmjet Sekretarisë.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Drejtuesi i senacës plenare, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtues i senacës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :

DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Këshilltar (Kr.Grupi):

Këshilltar (Kr. Grupi) :

Këshilltar (Kr. Grupi) :

FLUTURA KASA

FLORIAN TAHIRI

ROLANT XHELILAJ